



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.646/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Afijete Sada Gllogjani dhe Kymete Kicaj anëtare, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – thyerja e heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës, të mbajtura me datën 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 18.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet e palejuar ankesa Anr.646/2021, e datës 18.10.2021, parashtruar nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – thyerja e heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës, të mbajtura me datën 17.10.2021.

A r s y e t i m

Me datë 18.10.2021, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.646/2021 të parashtruar nga BIRN dhe Internews Kosova me të cilin thekson se kandidati për asamble komunale në Fushë Kosovë, Adem Breznica nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje u ka dërguar qytetarëve SMS më qëllim që të njëjtë ti ftoj që të dalin në zgjedhje që ta votojnë Lëvizjen Vetëvendosje dhe atë si kandidat. Sipas parashtruesit të ankesës ky veprim bie ndesh me planin operacional për organizimin e Zgjedhjeve Lokale, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullat e parapara të sjelljes për zgjedhje.

Ankesës i ka bashkangjitur fotografi të printuar me SMS-in e dërguar.

Paneli pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e ankesës gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa e parashtruar nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, ka njëjtësi subjektive, objektive, gjendje të njëjtë faktike me ankesën e parashtruar nga Lidhja Demokratike e Kosovës të paraqitur me datën 17.10.2021 kundër Lëvizjes Vetëvendosje e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr.629/2021 të datës 18.10.2021.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton se ankesa e parashtruar nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova është çështje e gjykuar “res iudicata”.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.629/2021 të datës 18.10.2021, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.646/2021 më datën 18.10.2021

Kryesues i Panelit

Adnan Konushevi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.